



KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL VII/2021

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 7 (shtatë) të rregullt për vitin 2021 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 21.07.2021
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Nexhat Ramadani
Z.Bashkim Ndrecaj
Z. Brahim Curri
Z. Alban Berisha
Z. Shefket Kolgeci
Z. Xhemajl Kabashaj
Znj. Elmaze Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi
Znj. Shqipe Ramaj
Z.Lirim Qatani
Z. Reshat Selimaj
Z. Ardian Kotorri
Z. Bexhet Kuçi
Z. Aziz Bytyqi
Z Gazmend Gashi
Znj. Bardha Gashi
Znj. Mirlinda Muqa

Z. Rilind Krasniqi
Z. Jeton Rrakaqi
Z. Arbërim Basha
Z. Dardan Berisha
Znj. Marigona Gashi
Znj.Florie Bytyçi
Z. Sami Hajdari
Znj.Shkëndije Zenelaj
Z. Osman Selimaj
Z.Leonard Shala
Z. Dugagjin Palushi
Znj.Laureta Tafaj
Z.Gëzim Kryeziu
Znj.Afërdita Morina

Të pranishëm të tjerë

Kryetari Komunës

**Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj.Habibe Bytyqi
Z.Xheladin Sadikaj**

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi dhe e prezantoi rendin e ditës:

REND DITE

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Raporti financiar i administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-qershor 2021;**
- 3. Informatë e KKSb-së për periudhën janar-qershor 2021 dhe informatë për gjendjen e sigurisë së përgjithshme në territorin e Komunës së Suharekës;**
- 4. Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit dhe e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - a keni ndonjë vërejtje në procesverbal?

Dugagjin Palushi - procesverbali është i cunguar, nga njëherë esenca mungon.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Miratohet

Pika 2. Raporti financiar i administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-qershor 2021;

Kryesuesi - e elanboron këtë pikë dhe hap debatin.

Nexhat Ramadani - përshëndet të pranishmit. Ne e kemi analizu raportin dhe shqetësuese është qështja e shfrytëzimit të mjeteve sa i përket investimeve kapitale. Në pasqyrën përfundimtare të shpenzimeve, del që investimet kapitale janë shpenzu 9.33 %. Në fillim të këtij viti shpenzimet janë të vogla, por kjo shifër është e pajustificueshme. Në KPF e kam diskutu që në raport emri i projekteve është i përgjysmuar dhe jo ashtu si është marrë vendimi në Asamble. Çka po ndodh me rrugën “Lasgush Poradeci në Leshan dhe rrugën “Valbona” në Bllacë, a është duke u ndërtu?

Kryetari - është e vërtetë që ka qenë në planifikim mirëpo kemi probleme me disa familje dhe nëse merren vesh mes vete, ne do të vazhdojmë me punu.

Agim Bylykbashi -përshëndet të pranishmit. Po realizimi i projekteve kapitale është i vogël, mirëpo duke i ditë procedurat e prokurimit të cilat marrin kohë, moti i keq dhe ankesat e operatorëve ekonomikë. 22.7% të projekteve kapitale janë të realizuara.

Enver Shabani - përshëndet të pranishmit. Në Leshan në rrugën “Lasgush Poradeci” nuk kemi problem pronor por kemi problem me kanalizim dhe njëherë e kemi pezullu.

Nexhat Ramadani – tash e kuptoj që është përqindja për total buxhetin edhe pse edhe kjo vlerë është e vogël. Edhe njëherë e potencoj që dukuria të cilën e kam potencu dy tre here është duke vazhdu. Rastin e Leshanit e kuptoj, e di që është problem kanalizimi, mirëpo ju prap keni bo rrugë që sjanë të planifikume. Rruga në Bllacë e cila është e miratune në Asamble dhe është prone publike, kemi informacione që përshkak të dikuj që kërkon me shty rrugën ,ju përshkak të atij personi e keni shty këtë proces dhe keni marrë rrugë tjera të cilat nuk janë në planifikim.

Cili është serioziteti i qeverisë tuaj?

Kryetari - bëhet për dy familjet, ku njëra është e invalidit të luftës. Mjete ka në Bllacë dhe rruga do të kryhet.

Enver Shabani - sasia që është e parapame në secilin fshat nuk shkon në asnjë fshat tjetër. Ne në Leshan stacionin që e kemi rregullu dhe para shtëpisë së Nexhatit, ato kanë qenë me projektin parkingje dhe trotuare.

Nexhat Ramadan – ju jeni tu bo diçka jashtë normales. Cila është arsyeja e dy rrugëve që i ke shtrur, rruga e Kryetarit të AAK-së dhe ajo tjetra? Përderisa ti nuk i rregullon ato rrugë që janë në listën e investimeve kapitale, ti nuk ke të drejtë me bo diçka tjetër nëse nuk është në listen e investimeve kapitale.

Enver Shabani - rruga e Ilir Kryeziut ku ju aludoni, ka qenë projekt i veçant, jo me parë të Leshanit. Kurse rruga Mërgimtari ka qenë në projekt.

Nexhat Ramadani - rruga Mërgimtari nuk është në listë të investime kapitale.

Ju në listë të investimeve kapitale keni diçka tjetër dhe në paramasë diçka tjetër. Leji këto arsyetime të kota.

Jeton Rrakaqi - përshëndet të pranishmit. Këtë punën e menaxhimit të buxhetit më së miri e ka dhanë projekti i auditimit, dhe kur të vje zyrtarisht në Asamble do ta diskutojmë.

Dugagjin Palushi - breng e kam , si do ti hargjoni 87.3 % , kur vetëm 22.7 % janë hargju. Janë disa rrugë që janë të shënune që sjan kry hiq, e janë do që janë kry 70-80%. Në Budakovë është e shënune në investime kapitale, rruga "Kroi i Fshatit" dhe su bo asgjë.

Kryetari - është e vërtetë që faza e parë e tenderimeve ka përfundu. Punët tjera janë në përfundim, kanë fillu pagesat prej korrikut. Rruga në Budakovë, e din që kemi problem për shkak të kontesteve.

Pika 3. Informatë e KKS-së për periudhën janar-qershor 2021 dhe informatë për gjendjen e sigurisë së përgjithshme në territorin e Komunës së Suharekës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pike dhe hap debatin.

Kryetari - unë kam kërku një raport me shkrim nga komandanti i stacionit policor, të cilin e keni edhe ju. Nëse keni pyetje urdhnoni.

Jeton Rrakaqi - raporti është i shkruar mire në letër. Pavarësisht angazhimit të tyre është shqetësuese sepse Kuvendi Komunal ka mujt mi dal në ndihmë, të paktën me makina për huazim. Vetë stacioni policor në Mushtisht i ka 9 zyrtarë dhe administron 11 fshatra të Suharekës, ndërsa as makinë nuk kanë. Kryetar, është dasht me marrë masa sepse Kuvendi Komunal ka mujt me ja huazu naj makinë. Komuna me 42 fshatra banorë me operu me dy makina, është shqetësuese.

Kryetari - gati çdo të dytën ditë policia i shfrytëzon makinat e Komunës, i marrin pas ores 4, mirëpo kur ti marrin i shkruajnë kilometrat dhe kush e ka marrë. Ne si Komunë ja kemi ofru dhe jemi duke bashkëpunu ndërsa me fal, skemi pas mundësi.

Jeton Rrakaqi – derisa ja ke fal ni klubi 88 mijë euro,një veturë 20 mijë euro ta kishim kalu në Asamble.Ne nuk kemi informata që policia merr kerre nga Komuna,komandanti ka thënë nuk keni ofru.

Kryetari - të jetë obligim me pyt komandantin, se a i merrnin kerret,dhe kur.

Kryesuesi - jam dëshmitar që posaqërisht vet ja kanë dhanë një kerr.

Leonard Shala - prioritet duhet me qenë lëvizja e lire e qytetarëve.Jemi dëshmitarë që kohët e fundit janë tejkalu ato që janë të lejume.Duhet me pas kujdes inspektoriati dhe policia që edhe në shesh mos me pas tejkalime ku vendosen karrige dhe tavolina sepse është bo e padurueshme kjo gjendje.Gjithëashtu shqetësuese është edhe te lokalet që ja lëshojnë zanin dhe bëhet si në diskoteka.

Kryetari - te qarkullimi i lire i qytetarit ke të drejtë.Drejtorja e inspeksionit është duke e përgatit një vijë,sa ka mundësi me kalu lokalet dhe sa s'ka, me lanë hapsirë të mjaftueshme.Te lokalet që ka muzikë,kem problem me ligjin që është në fuqi sepse asnjëherë skem mundësi me ja matë ato decimalet.

Alban Berisha - pse problem?

Kryetari - si kanë parapa parametrat.

Sami Hajdari - përshëndetje.Kisha pas dëshirë që vërtetë Suharekën ta quaj qyteti i luleve ashtu si e poston Kryetri, por më mire të quhet qyteti i hajnisë,sepse bëhen shumë vjedhje të rënda.Unë kisha kërku që ju si ekzekutiv dhe ne si asamble që të bëjmë ma të mirën për sigurinë e qytetarit.Mendoj që duhet të jetë një pikë e veqntë për sigurinë që duhet të diskutohet.

Dardan Berisha - përshëndet të pranishmit.Pothuaj një raport i përsëritur.Nëse ka drejtori ndonjë plan operativ për qështjen e sigurisë në shkolla,duhet të na informojë mirëpo unë nuk di që ka.Për mbrojtje nga zjarri gjatë pushimit veror,këtë vit nuk keni marrë puntor sezonal,a nuk keni pas të drejtë apo si? Plani operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve,si do të veprohet?

Kryetari - kemi problem me zjarrëfikësa sepse kemi një numër shumë të vogël, Nuk kemi të drejtë me marrë puntor me kontratë mbi vepër.

Remzi Bajselmani - përshëndet të pranishmit.Kemi pas një projek ku 90 % e shkollave janë pajis me kamera funksionale.Na kanë mbet disa paralele,për të cilat shkollat munden me rregullu me buxhetin e tyre vetanak.

Dardan Berisha -fokusi kryesor duhet të jetë te tri shkollat e mesme.Është një kabinë te gjimnazi dhe keni premtu sigurim fizik.Mendoj që tri shkollat e mesme duhet të kenë sigurim fizik te dera. Të gjitha dukuritë negative ndodhin te stacioni i autobusëve. Mendoj që bashkëpunimi juaj me inspektoriatin dhe policinë duhet të jetë më i hapur.

Remzi Bajselmani - ne e kemi pas këtë agjent,veqanërisht për tri shkollat e mesme.Polic civil dalin edhe patrollojnë te stacioni i autobusëve,poashtu frekuentojnë oborret e shkollave kur paraqitet ndonjë rast.Sa i përket kabinave në hyrje te shkolla,nuk është dizajnu mire puna për shkak të personelit.

Enver Shabani - raportet sipas zjarrëfikësve që i kemi marrë është se kanë qenë 156 intervenime,shumica kanë qenë zjarre.Javën që lamë pas temperaturat kanë qenë të larta dhe kemi pas 11 intervenime,ku kemi pas edhe dame materiale.Ne si drejtori kemi bo një apel dhe e kemi shpërnda nëpër të gjithë fshatrat.Numri i zjarrëfikësve është i vogël në krahasim me numrin e banorëve.Ka njerëz që na bashkohen në mënyrë vullnetare,por nuk e kanë obligative.Tre vende të lira të punës janë që nuk janë plotësu asnjëherë,mirëpo kjo është neglizhencë e ministrisë ose e angjensionit. Falemderoj Jetonin që është i vetmi asambleist që gjatë kohës së vërshimeve, kohë pas kohe ka qenë i informun dhe na ka ofru ndihmë ,dhe kryetarin e Mshtishtit Reshat Selimin.Të tjerët s'kan pas interesim.

Jeton Rrakaqi - zjarrëfikësit pos pagave kanë nevojë edhe për objekt, sepse ai objekt nuk i plotëson kushtet. Çka po ndodh me një objekt të cilin e kemi kalu në Asamble për zonën industriale. A i mirëmban dikush ato kamera në qytet, 30 % e tyre nuk punojnë?

Enver Shabani - sa i përket zjarrëfiksave kemi nda një vend në zonën industriale, mirëpo kemi pas problem me financat. Nëse kalon buxheti, besoj vitin e ardhshëm do të bëhet objekti i zjarrëfikseve.

Driton Maliqaj - përshëndet të pranishmit. Kontrata për mirëmbajtjen e kamerave është në vazhdim, pritet së shpejti të kontraktohet, mirëpo për shkak të ankesave kjo kontratë nuk është lidh.

Dardan Berisha - nëse keni mundësi vitin tjetër parashihni ndërrimin e kamerave, sepse sipas ekspertëve këto kamera janë më të dobëtat.

Driton Maliqaj - nuk është e vërtetë, jep sqarime.

Kryetari - portali dul, dhe thotë se është pyet komandanti i policies, ku thotë se policia vazhdimisht marrin makina nga Komuna.

Alban Berisha - a ka naj raport se sa janë efektive këto kamera. A ka pas më shumë efekt që e kanë cenu të drejtën e qytetarit.

Driton Maliqaj - jep përgjigje.

Dugagjin Palushi - kamerat kanë efekt pozitiv. Kam shqetësim të vetëdijësimi i nxënësve për rrezik nga mjetet shpërthyes. Të punohet me nxënës sa i përket vetëdijësimi të rrezikut prej narkotikëve, shisha bareve dhe alkoolit. Lokalet po frekuentohen shumë prej fëmijëve të vegjël, të cilët konsumojnë narkotik. Është mire policia dhe inspeksioni ti përcjellin këto.

Alban Berisha - Kryetar, ju drejtohem juve si kryesues i KKS-së. Krejt esenca e sigurisë ka të bëjë me rrugën brigada 123, magjistralja për Prizren. Harrojmë që edhe pjesët tjera janë pjesë e Komunës. Në zonën industriale thehen rregullat e komunikacionit dhe rrezikohet jeta e qytetarit, aty është edhe shkolla e mesme teknike dhe kur lëshohen nxënës aty bohen gara me makina. Unë i kam informu policinë, mirëpo shumë rrallë dalin. Mos e shihni vetëm rrugën "brigade 123". Si kryesues i KKS-së, ju kisha lut që me qu këtë mesazh në polici.

Kryetari - vazhdimisht e kam thirr komandantin e policisë dhe tash iu kam drejtu dhe me shkrim, edhe drejtorit në Prishtinë. Pra problem është që ka numër të vogël të policisë dhe automjete nuk kemi ndoshta fare. Për mua edhe zona industriale, edhe tranziti i pare, dhe lagjet kanë rëndësi të njëjtë. Nën kryetarja e Komunës çdo javë mban takimin e sigurisë. Në çdo fshat kërkohet të vendosen policë të shtrirë, mirëpo janë shenjat e komunikacionit.

Alban Berisha - është e natyrshme kërkesa prej fshatrave për police të shtrirë. Nuk thash me shtu numrin por të pakten me dal në shume lagje, psh. te ura në Suharekë, ku është bo si tranzit për shkak të kolonës.

Leonard Shala - drejtori i shërbimeve publike për punën e vërshimeve tregon për veten e vet. Për ty drejtor kam opinion të mire sepse je zero i korruptuar. Kur the që nuk kam pas telefonata prej asambleistave, mendoj që opinionin e asambleistave, i qytetarëve dhe i imi është që sa here tu kam drejtu në Asamble, qoftë edhe privatisht, asnjëherë nuk ke t, fillu punë, veq ke thënë po po. Ti je veq figure dhe askush për asgjë nuk të pyet.

Pika 4. Pyetje dhe përgjigje

Bashkim Ndrecaj - përshëndet të pranishmit. Vërshimet që kanë ndodh natën e dhjetë janarit, të gjithë asambleistët që i ka përfshi janë kanë aktiv. Kjo që thoni nuk është e ndershme. Rruga në Maqitevë Nebih Islami dhe Shaban Nuha kanë fillu mirëpo janë ndërpre punimet. Pse janë ndërpre

dhe kur do të rifillojë dhe rruga Haradinajt kur do të filloj? Kryetar, jam habit me propozimin tend për emërtimin e zones industriale. Këto emërtimet e fundit janë vetëm për politikë. Zona industriale e ka emrin e vet. Kryetar, i ke bo 4 -5 apele, KEDS-it, Hidroregjionit, Ministrisë. Merr masa sepse je kryetar për me marrë vendime për qytetarët e jo apele.

Kryetari - nuk ki drejt me marrë vendime për hidroregjionin, qytetarët thërrasin dhe kërkojnë me bo apel. Te zona industriale nuk kam presion nga askush. Në Maqitevë vazhdojnë rrugët.

Arbërim Basha – Kryetar, me dhanë këshilla për gjeneratat e reja, që 1800 veta janë punësu, e kanë lëshu Gjermaninë dhe kanë punu, se në atë kohë vetëm me thane Kosova Republikë ka qenë e turpshme.

Kryetari - ai prej viteve 80-ta nuk u kanë në skena politike. Nuk mundem me fol për të kaluarën e tij asnjëherë, unë e di që kanë hy në punë 1800 veta në Ballkan të Suharekës.

Bulëza Kuçi - përshëndet të pranishmit. Sa i përket drejtimit të infermierisë dhe shkencave në Shirokë, a ka mundësi me dhanë sqarime dhe dua ta di përgjigjen që e keni marrë prej Prishtinës. Kisha pas dëshirë me ndëgju një statistikë përfundimtare për arsimin, për sfidat e vitit 2020-2021 dhe prioritetet. Në qendrën e vaksinimit flitet që nuk po përfillen rregullat për mbajtjen e maskave dhe dorezave.

Remzi Bajselmani - ne kemi punu rreth një vit për hapjen e këtij drejtimi. Në takimet me ministrinë premtimet kanë qenë që do të kryhet kjo punë, por në përfundim një zyrtarë gjatë takimeve me drejtorët e shkollave profesionale, kanë marrë vendim që të shkohet me drejtimet e vitit të kaluar. Jemi prap në pritje për afatin e gushtit për mu realizu.

Bulëza Kuçi - a mendoni që i plotësojmë kushtet.

Remzi Bajselmani - i kemi kry të gjitha procedurat për hapjen e këtij drejtimi. Ndërsa sa i përket statistikave janë mbledhë të gjitha të dhënat, ku jemi taku me drejtorët e shkollave dhe është raportu. Matje të brendshme shumë sakt nuk kemi pas. Testi i matures ka shkuar shumë mire edhe pse rezultati është më i ulët.

Dardan Berisha - Ju mund të jeni të kënaqur por ne nuk jemi. Kurrë gjendja e arsimit më keq su kanë. Çdo konkurs është i manipulim. Sa sekretar i ka shkolla e mesme Abdyl Rama?

Remzi Bajselmani - jep përgjigje.

Dardan Berisha - në bazë të ligjit për arsimin parauniversitar duhet me qenë 1200 nxënës për me pas zëvendës drejtor. Ato janë emrime politike.

Bulëza Kuçi - vitin e kalim kemi pas probleme me libra. Këtë vit a jeni kujdes për këtë qështje.

Remzi Bajselmani - kemi punu rreth dy javë në këtë drejtim dhe shpresoj kanë me ardh me kohë.

Rilind Krasniqi - si është e mundur që emrat e kandidatëve dalin nëpër portale para se mu përfundu konkursi, ndërsa drejtori thotë që ka transparence.

Remzi Bajselmani - në transparencë dhe në përgjithësi, procedurat zhvillohen normalisht.

Xhemajl Kabashi - përshëndet të pranishmit. Kryetar, me një takim që ke pas me dy bashkëfshatar, ke deklarë që për një linjë kanalizimi, nuk po realizohet kanalizimi sepse ka pengesa nga fshatarët. Dua ta di në mënyrë publike kush janë ata banorë që pengojnë kanalizimin, apo veq është thënë e arsyetu?

Kryetari - unë e kam angazhu drejtorin e shërbimeve publike Të hënën kanë me dal dhe me u marrë vesh me qytetrë që me vazhdu ai kanalizim. Nuk kem pas probleme. Edhe, të kam thirr çdo here.

Xhemajl Kabashi - e ngrita këtë qështje sepse asnjë qytetar nuk është kundër kanalizimeve, dhe askush nuk e pengon.

Shefket Kolgeci - si po shkon procedura me vaksinën antikoovid a ka probleme me qytetarët që janë vaksinu, a ka vakcina për raundin e dytë për ata që janë vaksinu Kisha kërku që mbledhjen e

ardhshme të bëhet një raport për gjendjen e vaksinimit. Për kanalizimin në Vraniq, kërkoj informatë nga Drejtori i shërbimeve publike.

Besa Kuçi – përshëndet të pranishmit. Deri tani janë vaksinuar 12373 qytetarë të K. Suharekë. Sa i përket hapësirës nuk është mvarë nga menaxhmenti jonë por nga Ministria. Vaksina për momentin ka.

Shefket Kolgeci - cilat vaksina për momentin janë tu u apliku?

Besa Kuçi - Astra Zeneka dhe Fajzer, poashtu është e sigurume dhe doza e dytë.

Enver Shabani - punët kanë fillu para një jave. Projektin është duke e mbikqyr një ingjinierë e kontraktur privat dhe puna po shkon mire.

Shqipe Rama - kur do të fillojë kompenzimi për shujtat e administratës?

Kryesuesi - është kthyr negative nga ministria e pushtetit lokal, për arsye të mosplanifikimit në buxhet. Në seancën e radhës kemi me shfuqizu atë vendim dhe në shtator e planifikojmë në buxhet dhe e bim prap.

Dardan Berisha - sa mjete keni nda konkretisht për ndërtimin e bazenit në zonën e Duhlës?

Dugagjin Palushi - Kryetar, apelet që i bon në facebook, boni me shkrim në mënyrë zyrtare dhe tregona përgjigjet.

Zona industriale e ka emrin e vet dhe mos na bini mo.

Kryetari - bazeni që dy vite ka përfundu, gypat e ujit kanë shku që ni vit kurse ujësjellsi e ka obligim mi vendos pompat.

Dugagjin Palushi – te kualiteti i punëve dhe marrja e operatorëve me qmim të lirë, kualiteti është llo. Ne nuk mund ta ndryshojmë ligjin e prokurimit, mirëpo menaxheri i projektit nonstop duhet me qenë aty. Te pranimi i punëve, e denon niher ,dy ose pesë vjet ska drejt me marrë pjesë në tenderim ose mos ja lëshu fare. Enver, te Kryetarët dhe kryesitë e fshatrave, mos u çuditni që s' thirrin se nuk po bashkëpunoni me ta hiq.

Brahim Curri - Kryetar, a është më e rëndësishme stacionit të autobusëve me ju shfaq orari i linjave apo puna e Kryetarit mi bo reklam vetes. Arsyeja sepse kam prit 40 min dhe nuk mu ka shfaq asnjë linjë e orareve në ekran.

Kryetari - me sa e di linjat shfaqen, vetëm nëse ka pas naj defekt.

Ardian Kotorri - përshëndet të pranishmit. Kryesues siq po shihet ethet e fushatës kanë fillu. Unë i kuptoj dej me ni nivel por jo në këtë masë, ku shkun deri te drejtori i shërbimeve publike. Unë e përgëzoj për punën për këto katër vite sa ka qenë drejtor.

Leonard Shala - kur janë rregullu trotualet në rrugën Abdyl Ramaj, një komshi i imi i ka pre disa drunjë që kanë pengu në rrugë dhe e ka liru pronën për trotuar. Atëherë i keni premtu për mbjelljen e disa pishave për me kufizu atë pjesë. A është e vërtetë dhe kur ki mi kry dhe si ke mi kry?

Enver Shabani - kërkesa e Sedatit është e kahmotshme dhe besoj brenda javës kryhet.

Bashkim Ndrecaj – Ardian ne gjithmonë në seanca jemi kanë ma shumë. Drejtorit i thamë që kemi pas bashkëpunim të mire dhe nuk e kritikim për punën, por ai i përmendi veq dy asambleist, kurse e di që unë e kam thirr në telefon në vërshimet e janarit.

Jeton Rrakaqi -çka po ndodh me pagesat për të prekurit nga Kovid, dej ku ka shku dhe ku ka ngec.

Kryetari - jep përgjigje.

Alban Berisha - kisha pas dëshirë me na pru një raport në seancën e radhës për të gjitha punët që janë bo dhe nuk janë kry si duhet, dhe çfarë masa ke marrë për mi penalizu ato kompani që s, kanë punu si duhet ,dhe si janë rregullu, me çfarë buxheti.

Gëzim Kryeziu - përshëndet të pranishmit. Mbas kërkesës së banorëve në rrugën Ismail Qemali për ato therrat, a ka diçka apo të ndërmarrim ne diçka?

Enver Shabani - është e vërtetë kërkesa e Gëzimit. Kemi bisedu me ekoregjionin, komopania nuk e ka të specifikune atë pjesë dhe duhet me marrë dikënd privat.

Takimi përfundoi: 12:00

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj